



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD

GJS-2024-009

Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës – Fejzullah Rexhepi, bazuar në nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga A. Sh., nga Gjilani, kundër aktvendimit të Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan, më datë 03.09.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET SI E PABAZUAR, ankesa e A.Sh., nga Gjilani, e paraqitur kundër kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan V.S..

A r s y e t i m

Në Gjykata Supreme më datë 7 gusht 2024 është pranuar ankesa e palës A.Sh., e ushtruar ndaj kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan – V.S., tek Kryetari i Gjykatës Supreme si Autoritet Kompetent, sa i përket pretendimeve të shkeljeve disiplinore të Kryetarëve të Gjykatave Themelore dhe Kryetarit të Gjykatës së Apelit konform nenit 9 par.1 nënparagrafit 1.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Pala ankuese A.Sh., në ankesën e tij të parashtruar ndaj kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan, V.S., ka paraqitur pretendimet e tij se kjo gjykatë nuk funksionon sipas ligjit, për arsye se nuk i trajton palët në mënyrë të barabartë, nuk garanton siguri juridike dhe nuk është aspak efikase. Tutje në ankesën e tij pala pretendon se është krijuar pasiguri e plotë juridik për shkak trajtimit arbitrar të lëndës C.nr. 1923/21, të cilën e trajton gjyqtari B.S.. Pala ankuese nder të tjera, pretendon se S. dhe Xh.Sh., mund të tentojnë të bëjnë bartjen e të drejtave në mënyrë të kundërligjshme me ndihmën e Gjykatës Themelore në Gjilan, me qëllim të pengimit të drejtë të lëndës C.nr. 1932/21.

Me qëllim të vërtetimit të pretendimeve të palës, kryetari i Gjykatës Supreme, si autoriteti kompetent ka kërkuar nga kryetari V.S., të deklarohet lidhur me këtë rast dhe ka pranuar deklaratën e të njëjtit.

Në deklaratën e tij, kryetari S., ka deklaruar se pretendimet e palës për shkelje disiplinore janë të paqarta, por që edhe këto pak pretendime të paqarta nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuara. Duke shtuar tutje se i njëjti në vazhdimësi ka pasur kërkesa dhe ankesa të ndryshme jo vetëm ndaj tij si kryetar por edhe ndaj të gjithë gjyqtarëve që kanë në punë lëndë të tij. Në deklaratën e kryetarit thuhet se të gjitha ankesat dhe pretendimet e palës të parashtruara ndaj tij si kryetar por edhe ndaj gjyqtarëve janë shqyrtuar dhe se të gjitha si të atilla kanë qenë të pabazuara.

Kryetari i Gjykatës Supreme pas shqyrtimit të pretendimeve në ankesës vlerësoi se:

- Ankesa është e pabazuar.

Pas analizimit të pretendimeve të ofruara nga parashtruesi i ankesës, deklarata e kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan, si dhe shkresave të lëndës, si autoritet kompetent vlerësoj se në rastin konkret nuk ka bazë ligjore për të hapur rast disiplinor ndaj kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan, V.S..

Në fakt ankesa e parashtruar është dukshëm joserioze, ngase nuk kemi një përshkrim konciz të aspekteve faktike dhe juridike mbi të cilat është ngritur ankesa për shkelje disiplinore të kryer nga kryetari i Gjykatës, dhe për me tepër këto pretendime nuk argumentohen. Në këtë rast pretendimet e palës, jo vetëm se janë të paqarta, por gjithashtu të pabazuara dhe si të tilla nuk mund të justifikonin inicimin e një procedure disiplinore ndaj kryetarit.

Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në mënyrë shprehimore në nenin 5, ka paraparë rastet në të cilat konsiderohet se është kryer shkelje disiplinore, në rastin konkret rezulton se veprimet e kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan, V.S., nuk kanë konsumuar ndonjë nga shkeljet e parapara me këtë Ligj.

Andaj, për shkak se në parashtrësën e palës, nuk potencohet ndonjë shkelje konkrete e supozuar disiplinore, të cilat janë të parapara në nenin 5 të ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Fejzullah Rexhepi
Kryetar i Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
2. Kryetarit të Gjykatës Themelore të Gjilan,
3. Palës ankuese,
4. Arkivit të Gjykatës Supreme.